

Mbledhja e Bordit të Informacionit Gjeohapësinor

Në datën 28.03.2024 u zhvillua në ambientet e Kryeministrisë mbledhja e Bordit të Informacionit Gjeohapësinor (BIG), nën drejtimin e Kryetarit të këtij bordi z. Ermal Nufi.

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), znj. Vilma Tomço, evidentoi arritjet kryesore të ASIG gjatë vitit 2023 dhe objektivat e punës për vitin 2024.

Në këtë mbledhje u prezantuan dy projekt akte të parashikuara nga ASIG për vitin 2024:

- Projektligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 72/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë""
- Projekt vendimi për një ndryshim në dokumentin "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri –Tema: Imazhi i hartës bazë"


Pas prezantimeve dhe diskutimeve të zhvilluara, anëtarët e BIG shprehën miratimin e tyre për këto projekt akte.

Një pikë tjetër e rendit të ditës në këtë mbledhje ishte prezantimi i projekteve dhe rolit të Institutit të Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake (IGJIU) në fushën e gjeoinformacionit në Shqipëri.




Krijimi i Instant-App “Njësitë Administrative - Rendi 3 - Bashkitë”

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet publike përfituese të shërbimit satelitor, ASIG ka ndërtuar Instant-App “Njësitë Administrative - Rendi 3 - Bashkitë”, nëpërmjet të cilit janë paraqitur Web Map-et për secilën bashki. Kjo mundëson aksesimin e shtresave të serrave bujqësore, ortofotos, imazhit CIR, NDVI - Indeksit të normalizuar të vegjetacionit, NDWI - Indeksit të normalizuar të ujit, EVI - Indeksit të përmirësuar të vegjetacionit, SAVI - Indeksit të vegjetacionit të rregulluar në tokë dhe LAI - Indeksit të sipërfaqes së gjetheve.



Publikim i informacionit gjeohapësinor për temën “Infrastruktura Urbane dhe Shërbimet Qeveritare” në Gjeoportalin Kombëtar



ASIG në rolin e autoritetit publik përgjegjës për temën “Infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare”, ka publikuar në Gjeoportalin Kombëtar informacionin gjeohapësinor për shtresat “Institucionet Publike” dhe “Sistemi i Drejtësisë”.

Në këto shtresa shfaqet pozicionimi i objekteve të institucioneve publike, prokurorive, sistemit gjyqësor dhe sistemit penitenciar, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Për të aksesuar këtë shtresë në Gjeoportalin Kombëtar [klikoni këtu](#).

TRAJNIME PËR GJEONFORMACIONIN

Në kuadër të nismës së ndërmarrë nga ASIG me qëllim rritjen e kapaciteteve të 61 Bashkive të vendit, ekspertë të ASIG realizuan gjatë këtij muaji, trajnime me stafet teknike të bashkive të Republikës së Shqipërisë, si më poshtë:

- Bashkia Tiranë;
- Bashkia Kamëz;
- Bashkia Vorë;
- Bashkia Krujë;
- Bashkia Shijak;
- Bashkia Durrës.

Tematikat e trajtuara në këto trajnime janë:

1. Njohja me funksionalitetet e Gjeoportalit Kombëtar;
2. Mbledhja e të dhënave sipas temave të gjeoinformacionit për: Njësitë administrative dhe fshatrat në përbërje të tyre (rendi 4 dhe 5), Rrjeti i transportit rrugor lokal;
3. Prezantimi i produkteve të përfuara nga projekti i Shërbimit Satelitor.

Kjo nismë do të vijojë në të gjitha bashkitë e vendit, përgjatë periudhës në vazhdim.



Takim i ASIG me përfaqësues të kompanive “WhereTech” dhe “Up to you”

Drejtues të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), zhvilluan një takim me përfaqësues të kompanive italiane të fushës së gjeoinformacionit “WhereTech” Srl dhe “Up to you” Srl, i cili kishte në fokus shkëmbimin e eksperiencave mbi krijimin dhe përpunimin e informacionit gjeohapësinor nëpërmjet metodave me teknologji të avancuara të remote sensing dhe krijimin e hartave bazë.

Të pranishmit në këtë takim diskutuan gjithashtu, mbi mundësitë potenciale të bashkëpunimit për realizimin e projekteve në të ardhmen.



Leksion i hapur me studentët e Universitetit “Polis”



ASIG zhvilloi leksionin e hapur më studentët e vitit të parë, master profesional për “Planifikim Urban dhe GIS”, të Universitetit POLIS, duke trajtuar temën “Gjeoportali Kombëtar dhe përdorimi i tij”. Ky leksion u drejtua nga ekspertët e ASIG, të cilët shpjeguan rëndësinë e gjeoinformacionit dhe mundësitë e shumta të përdorimit të tij nëpërmjet Gjeoportalit Kombëtar për planifikimin urban dhe menaxhimin e territorit.

PJESËMARRJE NË AKTIVITETE

Asambleja e Përgjithshme e EuroGeographics 2024

Në Asamblenë e Përgjithshme të EuroGeographics për vitin 2024, e cila u zhvillua në Sevilje, Spanjë, më datë 18 - 20 Mars 2024, me mbështetjen e Institutit Kombëtar Gjeografik të Spanjës, morën pjesë mbi 110 delegatë, nga 40 vende anëtare, pjesë e së cilës është dhe Shqipëria.

Ekipi i ASIG u kryesua nga Drejtori i Përgjithshëm znj. Vilma Tomço, e cila moderoi panelin “E ardhmja e informacionit gjeohapësinor”. Diskutimet e kësaj Asambleje kishin në fokus të dhënat gjeohapësinore të vendeve anëtare dhe rolin e tyre në ofrimin e informacionit themelor për të gjetur zgjidhje mbi sfidat e ndryshme globale.



Takim në kuadër të projektit “Krijimi i Qendrës së Gjeoinformacionit në Ballkanin Perëndimor”

Universiteti Bujqësor i Tiranës organizoi Kick-off Meeting, në kuadër të projektit “Krijimi i qendrës së gjeoinformacionit në Ballkanin Perëndimor” ku ishin të pranishëm të gjitha palët me interes në këtë projekt ndër të cilët dhe Drejtori i Përgjithshëm i ASIG, znj. Vilma Tomço.

Znj. Tomço në fjalën e saj paraqiti hapat e hedhur nga ASIG për krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri duke theksuar rolin e informacionit gjeohapësinor në sektorin bujqësor si dhe bashkëpunimet që ASIG ka me botën akademike.



Workshop “Forcimi i aksesit profesional në informacionin rreth tokës, në rajonin e Ballkanit Perëndimor”



Përfaqësues të ASIG morën pjesë në workshop-in “Forcimi i aksesit profesional në informacionin rreth tokës, në rajonin e Ballkanit Perëndimor”, i cili u zhvillua në datat 7 - 8 mars 2024, në Mostar të Bosnjë Hercegovinës. Ky aktivitet u organizua nga Agjencia Kadastrale dhe Hartografike Hollandeze “Kadaster”, në kuadër të projektit “SPATIAL II”. Ekspertët e ASIG, prezantuan projektet e realizuara në fushën e Remote Sensing duke cilësuar në veçanti projektin e “Shërbimeve Satelitore”.

BOTA E GJEONFORMACIONIT

Projekti Open Maps For Europe (OME) 2 shpall planet për Strategjinë Pan-Europiane të të dhënave Kadastrale

Projekti OME2 po përmirëson prototipin e Hartës Kadastrale të Hapur, i cili është i disponueshëm përmes ndërfaqes së Hartave të Hapura për Evropën dhe aktualisht ofron mbulim në shkallë të gjerë për gjashtë vende europiane. Strategjia pan-evropiane e të dhënave kadastrale do të përcaktojë palët e interesuara, si dhe teknologjinë, proceset, burimet dhe praktikën më të mira të nevojshme, për të mbështetur shpërndarjen afatgjatë të të dhënave zyrtare të vlefshme për adresat, parcelat kadastrale, ndërtesat dhe njësitë administrative.

“Croydon”, shkolla e parë në Mbretërinë e Bashkuar që lëshon satelitin në orbitën e ulët të Tokës

Një ekip nxënësish nga Klubi i Astrogazers i Shkollës së Mesme “Croydon”, bashkëpunoi me Universitetin e Bath për t'u shpallur shkolla e parë në Mbretërinë e Bashkuar e cila lëshoi dy balona meteorologjike në hapësirë. Këto të fundit u lëshuan 32,000 metra në hapësirë duke fotografuar me sukses imazhet e Tokës. Pas kësaj arritjeje, sfida e radhës së klubit Astrogazers është lëshimi i një CubeSat (satelit) në orbitën e ulët të tokës.

AKTIVITETE NË VIJIM

Amsterdam Drone Week

Amsterdam Drone Week është platforma e parë zyrtare evropiane për përdoruesit, prodhuesit, shërbimet dhe rregullatorët e industrisë UAS (Unmanned Aircraft System). Ky aktivitet ka në fokus bashkëpunimin midis aktorëve kryesorë të sektorëve komercialë dhe jo-komercialë dhe instituteve kërkimore për teknologjitë më të fundit të dronëve dhe zbulimin e aplikacioneve të reja.

16-18 Prill 2024

www.asig.gov.al

Geospatial World Forum (GWF)

Forumi Botëror Gjeohapësinor (GWF) organizon në Roterdam, Mbretëria e Holandës, një konferencë katër ditore për profesionistë të angazhuar në përfaqësimin e gjithë ekosistemit të politikave publike, agjencive kombëtare të hartografisë, sektorit privat, organizatave, institucioneve shkencore dhe akademike.

13-16 Maj 2024

International Geoscience and Remote Sensing Symposium (IGARSS)

IGARSS 2024 Simpoziumi Ndërkombëtar i Gjeoshkencës dhe Remote Sensing”, do të zhvillojë një aktivitet 6 ditor, në Athinë të Greqisë. Ky aktivitet do të kontribuojë në shkëmbimin e pikëpamjeve, përvojave dhe trajnimit të shkencëtarëve të rinj, duke hapur perspektiva të reja për zhvillimin e kërkimit dhe investimet në këtë sektor.

7 - 12 Korrik 2024

www.geoportal.asig.gov.al